



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME
SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA
SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREM COURT

G.J.A-Su.A.C.A

50/2022

Dt:

21.04.2022

PRISHTINË - PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

- **Për:** Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)
- **Nga:** Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Republikës së Kosovës (DHPGJS)
- **Datë:** 21 prill 2022
- **Lënda:** RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUdhËN 1 janar – 31 mars 2022

Lëndët në punë

Në DHPGJS gjatë tremujorit të parë kanë qenë të angazhuar 13 gjyqtarë në zgjidhjen e lëndëve, 10 prej tyre në shkallën e parë dhe 3 në shkallën e dytë, gjegjësisht në Kolegjin e Apelit.

Gjithsej në dy shkallët gjyqësore në fillim të tremujorit të parë të vitit janë trashëguar nga viti paraprak 15665 lëndë, janë pranuar edhe 362 lëndë të reja, kështu gjatë tremujorit në punë kanë qenë gjithsej 16027 lëndë.

Në shkallën e parë gjyqësore të trashëguara janë 14675 lëndë, të pranuar gjatë tremujorit janë 205 lëndë, kështu gjatë tremujorit të parë në punë kanë qenë 14880 lëndë të shkallës së parë.

Në shkallën e dytë gjyqësore të trashëguara janë 990 lëndë, të pranuar gjatë tremujorit janë 157 lëndë, kështu gjatë tremujorit të parë në punë kanë qenë 1147 lëndë të shkallës së dytë.

Mesatarja e ngarkesës së gjyqtarëve me lëndë

Mesatarisht një gjyqtar i shkallës së parë ka qenë i ngarkuar me 14880 lëndë.
Mesatarisht një gjyqtar i shkallës së dytë ka qenë i ngarkuar me 382.33 lëndë.

Lëndët e zgjidhura

Gjatë tremujorit në dy shkallët gjyqësore gjithsej janë zgjidhur 826 lëndë.
Në shkallën e parë gjyqësore janë zgjidhur 626 lëndë.
Në shkallën e parë gjyqësore janë zgjidhur 200 lëndë.

Mesatarja e zgjidhjes së lëndëve për gjyqtarë

Mesatarisht një gjyqtar i shkallës së parë ka zgjidhur 62.6 lëndë.
Mesatarisht një gjyqtar i shkallës së dytë ka zgjidhur 66.66 lëndë.

Lëndët e pazgjidhura në fund të tremujorit të parë

Gjithsej në dy shkallët gjyqësore në fund të tremujorit kanë mbetur të pazgjidhura 15201 lëndë.
Në shkallën e parë gjyqësore të pa zgjidhura kanë mbetur 14254 lëndë.
Në shkallën e dytë gjyqësore të pa zgjidhura kanë mbetur 947 lëndë.

Mesatarja e lëndëve të pa zgjidhura për gjyqtar në fund të tremujorit të parë

Mesatarisht për një gjyqtar të shkallës së parë mbeten të pa zgjidhura 1425.40 lëndë.
Mesatarisht për një gjyqtar të shkallës së dytë mbeten të pa zgjidhura 315.66 lëndë.

Publikimi i vendimeve

Gjatë tremujorit është vazhduar me publikimin e vendimeve të Gjykatës, kështu që janë publikuar në Web faqe gjithsej 566 vendime të Dhomës. Prej tyre 418 vendime janë të shkallës së parë gjyqësore kurse 148 janë të shkallës së dytë.

Identifikimi i problemeve dhe propozimi për zgjidhjen e tyre

Problem i vazhdueshëm në DHPGJS është numri i pamjaftueshëm i stafit gjyqësor dhe atij administrativ. Duke patër parasysh numrin e madh të lëndëve dhe numrin e stafit aktual është shumë e vështirë dhe e pa mundur të zgjidhen lëndët e grumbulluara në një afat të arsyeshëm. Kështu i propozohet KGJK-ës që të ketë në vëmendje zgjidhjen e këtij problemi duke shtuar numrin e stafit gjyqësor dhe atij administrativ në DHPGJS sa më parë që të jetë e mundur. Meqenëse është në procedurë të KGJK-ës procesi i emërimit të tre gjyqtarëve të rijë për DHPGJS, është e nevojshme që të emërohen edhe punonjës administrativ siç janë bashkëpunëtorë, zyrtarë ligjor, referentë, etj.

Gjatë tre mujorit Gjykata është ballafaquar edhe me kufizime të kohëpaskohshme të stafit për shkak të gjendjes me pandeminë. Dy punonjëse kanë qenë në vetë izolim shtëpiak sipas rekomandimeve të IKSHPK-ës për nga 10 ditë pasi që kanë patër të infektuar anëtarë të ngushtë të familjes. Tri punonjëse kanë rezultuar pozitiv në testimin për covid të cilat gjithashtu kanë qëndruar në shtëpitë e tyre nga 10 ditë. Gjithnjë është kërkuar nga stafi prezent që të angazhohen në kryerjen e punëve edhe të punonjësve që kanë munguar.

Gjatë muajit mars të këtij tre mujori si problem është identifikuar edhe greva e stafit administrativ e cila është reflektuar edhe në punën e Gjykatës. Pas ndërprerjes së saj është kërkuar nga stafi angazhim maksimal në mënyrë që të kryhen edhe punët e mbetura pa u kryere gjatë grevës.

Si problem është identifikuar edhe data baza e të dhënave për lëndët e Dhomës e cila është shumë e ngarkuar dhe zyrtarëve të Gjykatës po u krijo vonesa dhe vështirësi gjatë regjistrimit dhe gjenerimit të të dhënave lidhur me lëndët. Shpresojmë që ky problem do zgjidhet gjatë këtij viti pasi që siç jemi njoftuar nga KGJK-ja, janë bërë përgatitjet e duhura për fillimin e trajnimeve dhe implementimin e SMIL-it edhe në DHPGJS. Në ndërkohë është filluar me trajnimin e stafit në gjykatë.